

TRAJNIM PËR NGRITJE TË KAPACITETEVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

14 - 30 tetor 2022 (të konfirmohet)

Prishtinë

THIRRJE PËR APLIKIME

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) fton përfaqësuesit e organizatave të vogla dhe të mesme të shoqërisë civile (OSHC), me seli jashtë Prishtinës, për të marrë pjesë në programin e trajnimit që synon: (i) ngritjen e kapaciteteve të tyre të brendshme organizative dhe menaxheriale, (ii) përmirësimin e pajtueshmërisë së tyre me kornizën administrative dhe ligjore në fuqi, (iii) zhvillimin e partneriteteve me OSHC-të/akterët e tjerë përkatës, si dhe të nismave të përbashkëta të avokimit.

HISTORIKU DHE ARSYETIMI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT

Në gjysmën e parë të vitit 2022, OSBE-ja ka realizuar një vlerësim të nevojave dhe një sërë konsultimesh me organizatat ombrellë të OSHC-ve, organizatat ndërkombëtare, donatorët dhe institucionet qeveritare lidhur me çështjet me të cilat përballet shoqëria civile. Si rezultat i këtij procesi janë identifikuar nevojat për trajnime për ngritje të kapaciteteve dhe fuqizimin e OSHC-ve lokale si më poshtë:

- Trajnim për ciklin e menaxhimit të projekteve që synon t'u ndihmojë OSHC-ve të vogla dhe të mesme ta përcaktojnë misionin, të hartojnë plane strategjike dhe matën arritjet e tyre.
- Trajnim për hartimin e PSV-ve të brendshme me qëllim arritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e performancës dhe komunikimit të brendshëm e të jashtëm.
- Trajnim për përmirësimin e menaxhimit financiar me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të një organizate.
- Trajnim për rritjen e pajtueshmërisë së OSHC-ve me kornizën ligjore në fuqi, për t'u ndihmuar atyre në tejkalimin e vështirësive për qasje në fondet publike në dispozicion në nivel ministror dhe lokal dhe për të siguruar pajtueshmëri me rregulloret administrative/financiare në fuqi.
- Trajnim për avokim që synon të ndihmojë OSHC-të në ndërtimin e partneriteteve ndërsektoriale me OSHC-të e tjera dhe akterët përkatës.

Aktivitetet e OSHC-ve të vogla dhe të mesme përgjithësisht karakterizohen me cenueshmëri financiare dhe qëndrueshmëri të ulët. Në këtë kontekst, vazhdon të ketë nevojë për ngritje të kapaciteteve, veçanërisht në fushat e avokimit dhe ndërtimit të partneriteteve.

PËRMBLEDHJA E TRAJNIMIT DHE DATAT TENTATIVE:

Trajnimi do të përbëhet nga tri modulet e mëposhtme:

I. Moduli i parë - Hartimi i dokumenteve të brendshme cilësore

Trajnim njëditor me mentorim njëditor për hartim/rregullim të dokumenteve të brendshme të OSHC-ve, siç është mandati i organizatës dhe PSV-të - 14 tetor 2022.

II. Moduli i dytë - Rritja e përputhshmërisë së OSHC-ve me kornizën ligjore në fuqi, me fokus në raportimin financiar dhe përdorimin e softuerit më të zakonshëm të menaxhimit financiar.

Trajnim dyditor me ushtrime praktike mbi përdorimin e softuerit të menaxhimit financiar dhe raportimin financiar, 15-16 tetor 2022.

III. Moduli i tretë - Si të avokoni me sukses dhe të ndërtoni partneritet me OSHC-të e tjera dhe akterët përkatës

Trajnim dyditor me ushtrime praktike dhe mentorim njëditor për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve/aftësive për avokim dhe/ose ndërtim të partneriteteve, 29-30 tetor 2022.

Çdo modul i trajnimit do të zhvillohet me pjesëmarrje fizike, në Prishtinë ose rrethinë të saj, dhe do të zhvillohet në gjuhën shqipe/serbe/angleze. Gjatë programit të trajnimit do të respektohen të gjitha masat që kanë të bëjnë me COVID-19.

KOHËZGJATJA E TRAJNIMIT: Pesë ditë, plus tri ditë mentorim.

Njohuritë e pjesëmarrësve rreth temave të propozuara do të vlerësohen para dhe pas programit të trajnimit.

Vetëm pjesëmarrësit të cilët do të ndjekin trajnimin gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij do të pajisen me certifikatë.

Programi i trajnimit është i dedikuar vetëm për përfaqësuesit e OSHC-ve të vogla dhe të mesme që punojnë aktivisht jashtë Prishtinës.

Inkurajohen të aplikojnë përfaqësuesit e OSHC-ve të themeluara në zonat e banuara nga komunitetet joshumicë.

**TRAJNIM PËR NGRITJE TË KAPACITETEVE TË
ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE**

14 – 30 tetor 2022 (të konfirmohet)

Prishtinë

KUSHTET PËR APLIKIM

Nga pjesëmarrësit pritët të jenë të pranishëm dhe të angazhohen aktivisht në të gjitha aspektet e programit të trajnimit. Diskutimet dhe shkëmbimi i mendimeve, duke respektuar dallimet në mendim dhe përkatësi, do të inkurajohen dhe vlerësohen shumë. Vëmendje e konsiderueshme në kuadër të këtij programi do t'i kushtohet ndërtimit të partneriteteve dhe përpjekjeve të përbashkëta avokuese ndërmjet OSHC-ve dhe akterëve përkatës, për ç' gjë pritët që pjesëmarrësit të angazhohen plotësisht.

KRITERET DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES:

Procesi i përzgjedhjes do të bëhet në dy faza: (i) shqyrtimi i letrave motivuese dhe përshkrimeve të organizatave, (ii) intervista online me kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.

Aplikuesit duhet të përfaqësojnë organizata që janë të regjistruara ligjërisht në Kosovë dhe që janë aktive në rolin e tyre.

Pranueshmëria e aplikantëve bazohet në kriteret e mëposhtme:

- **Zona gjeografike** – Do të pranohen vetëm OSHC-të që veprojnë jashtë Prishtinës, ndërsa OSHC-të që veprojnë në zona të banuara kryesisht nga komunitetet joshumicë do të kenë përparësi;
- **Madhësia e OSHC-së** - Vetëm OSHC-të e vogla dhe të mesme buxheti i të cilave nuk i kalon 50.000 euro do të merren parasysh.
- **Fushëveprimtaria** - Përparësi do t'u jepet OSHC-ve të angazhuara në fushat e mëposhtme: (i) pjesëmarrja publike e grupeve të komunitetit joshumicë, veçanërisht e të rinjve dhe grave, (ii) pjesëmarrja publike e të rinjve, (iii) përfshirja dhe pjesëmarrja publike e grupeve të cenueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Gjithsej 20 aplikantë të suksesshëm, të cilët i plotësojnë kriteret e mësipërme, do të përzgjidhen për të marrë pjesë në programin e trajnimit.

APLIKIMI:

Nëse jeni të interesuar për këtë mundësi trajnimi dhe i plotësoni kushtet e mësipërme, **ju lutemi të dorëzoni një letër motivimi ku duhet të sqaroni se si organizata juaj do të përfitonte nga ky program i trajnimit.**

Veç kësaj, ju lutemi të **jepni përshkrimin e vizionit, misionit dhe aktiviteteve/programeve të realizuara nga organizata në dy vitet e fundit, duke përfshirë si në vijim:**

- Mbulimin gjeografik, d.m.th. ku është themeluar dhe ku vepron organizata;
- Numrin e punonjësve me afat të caktuar dhe/ose vullnetarëve;
- Të hyrat vjetore për dy vitet e fundit;

- Përshkrimin e fushave specifike të punës dhe të përfituesve;
- Përshkrimin e trajnimeve specifike, nëse ka të tilla, që i kanë vijuar anëtarët/punonjësit tuaj gjatë vitit të kaluar;
- Përshkrimin e bashkëpunimeve/partneriteteve përkatëse me OSHC-të tjera/akterët përkatës që organizata juaj i ka krijuar tanimë;
- Përshkrim të shkurtër të projekteve në realizim e sipër, duke përfshirë burimin e financimit;
- Informatat e kontaktit (numrin e telefonit dhe adresën e emailit).

Përshkrimi nuk duhet të jetë më i gjatë se dy faqe.

Ju lutemi të dërgoni pakon e aplikimit në adresën e mëposhtme të emailit: Dafina.Bajrami@osce.org. Në rubrikën e titullit (subject line) të emailit shkruani: *Aplikim për trajnim për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve.*

Nëse njoftoheni se jeni një nga aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë, mund t'ju kërkohet që të ofroni dokumente tjera shtesë siç është certifikata e regjistrimit dhe dëshmia e të hyrave vjetore.

Ju lutemi vini re se aplikacionet që nuk janë në përputhje me **të gjitha** udhëzimet e cekura më sipër **nuk do të merren parasysh.**

Ju lutemi të dorëzoni aplikacionin më së voni deri 00:00h më 15 shtator 2022, sipas zonës kohore të Evropës Qendrore - CET

OSBE-ja është e përkushtuar për arritjen e diversitetit, andaj aplikuesit nga radhët e të gjitha komuniteteve inkurajohen të aplikojnë.

SHËNIM¹:

Pjesëmarrësit do të përzgjidhen në bazë të kritereve të përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe cilësinë e aplikacioneve të dorëzuara, duke mbajtur parasysh konsideratat e barazisë gjinore, diversitetit dhe ekuilibrit gjeografik.

Ju lutemi vini re se të gjithë pjesëmarrësit e përzgjedhur për të marrë pjesë në trajnim do të njoftohen me email më së voni deri më 20 shtator 2022.

Çdo pyetje eventuale mund të drejtohet në adresat e mëposhtme të emailit:

Boris.Sekulic@osce.org

Dafina.Bajrami@osce.org

¹ Ju lutemi vini re se duke i ofruar të dhënat tuaja personale, ju e jepni pëlqimin tuaj që Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK) t'i mbledhë, përpunojë, ruajë dhe transferojë të dhënat tuaja sipas nevojës për qëllime të këtij aktiviteti. Të dhënat personale që ju i jepni do të përdoren për të çuar përpara mandatin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, që përfshin ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe monitorimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Të dhënat tuaja personale mund të përdoren brenda organizatës për qëllime të këtij trajnimi. Ato mund të përdoren jashtë organizatës për qëllim të tërheqjes së vëmendjes së publikut për këtë trajnim, megjithatë, ato nuk do të ndahen jashtë OSBE-së pa pëlqimin tuaj paraprak.